

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRN

Nr./Br. 37144/25

Nr. i fq. / Br. st. -2-

Data: / Datum: 30.07.25

VUSHITRI - VUČITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 127/25, 30/07/2025

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 15 korrik 2025 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:45.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin: Zdravko Zdravkoviç (kryesues), Zojë Hajrizi, Kushtrim Hyseni, Behar Duraku, Gresa Muli, Berat Maloku, Zana Krasniç Saraçi, Aziz Emini dhe Adem Hoti, anëtarë të komitetit.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: përfaqësues të KFOR-it slloven, UNMIK-ut, Aktere Dërvari - përkthyes, si dhe Bujar Klinaku nga sekretaria e kuvendit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Zdravko Zdravkoviç, kryesues i Komitetit për Komunitete, i cili konstatoi se ekziston shumica për punë.

Komiteti për Komunitete njëzëri aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Diskutim i hapur për mundësinë e punësimit të të rinjve;
3. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Komiteti për Komunitete njëzëri aprovoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

2. Diskutim i hapur për mundësinë e punësimit të të rinjve.

Zdravko Zdravkoviç, kryesues i komitetit – deklaroi se paraqet sfidë për të gjithë. Ai tha se shumë rinj kanë gjetur vende pune, por ato pozita të punës nuk janë serioze për shkak të pagave të vogla. Shpresojmë që në të ardhmen do të ketë më shumë vende pune. Së shpejti do të mbahen zgjedhjet lokale dhe shpresojmë për ndonjë zgjidhje më të mirë.

Berat Maloku, anëtar i komitetit – theksoi se nuk është interes i të rinjve që të punësohen në sektorin publik, sepse në sektorin privat marrin paga më të mëdha. Shpresojmë se në të ardhmen do të rriten pagat në sektorin publik. Ai tha se kishte një mundësi që të punësohen në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, por paga e ultë, kurse

shpenzimet e mëdha. Pas zgjedhjeve, kryetari i komunës t'i angazhojë disa të rinj me kontratë mbi vepër deri në gjashtë muaj.

Po ashtu, komuna të subvencionojë trajnime për të rinj dhe të përfshihen edhe komunitetet joshumicë.

Aziz Emini, anëtar i komitetit – tha se 40 persona nga komuniteti rom janë të papunë. Ai theksoi se kanë gjetur punë, por paga e vogël. Si pasojë e kësaj ka raste që edhe e kanë lëshuar punën.

3. Të ndryshme.

Zdravko Zdravković, kryesues i komitetit – tha se gjatë mbajtjes të takimit publik me qytetarë në Prelluzhë, lidhur me hartimin e draft-buxhetit për vitin 2026 është takuar me drejtorin e Prokurimit, Ilmi Azemin, ku ka biseduar për disa prioritete. Në mesin e tyre kemi biseduar edhe për mundësinë e heqjes së antenës afër lagjes rome. Ai shprehu vullnetin e tij që të hiqet antena.

Kemi biseduar edhe për hudhjen e mbeturinave, ai tha se inspektorati do të dal në terren.

Mbledhja përfundoi në ora 11:05.

Bujar Klinaku

Procesmbajtës



Zdravko Zdravković

Kryesues i K. për Komunitete